



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm për Sherbime Publike dhe Prona

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 1 datë 17.04. 2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 1 datë 11/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin “Për Miratimin për Shitjen me Ankand të Aksioneve të Klubit të Futbollit "Fk Tërbuni" SHA me Nipt L19704301F në masën 100%”

Analiza ligjore: Mbeshtetur në nenin 113,pika 2 të ligjit nr.8417,datë 21.10.1998"Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë"të ndryshuar nenit 8,pika 2,neni 9 pika 1,nënpika 1.1 shkronja "b", nën pika 1.2 shkronja "a", nenit 54 gërma"e" të ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015 "Per Vetëqeverisje Vendore"i ndryshuar, ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tragtarët dhe shoqëritë tregtare"të ndryshuar, Ligjin nr.79/2017 date 27.04.2017"Për Sportin'i ndryshuar,Ligjit nr.9874,dt. 14.02.2008"Për ankandin publik" i ndryshuar, themeluar si Shoqeri Aksioner me date 14.10.2011.

Situata aktuale e funksionit:

Kjo kërkesë vjen si rezultat i përcaktimeve ligjore për detyrimin e pushteti vendor per privatizimin e klubeve sportive i shoqeruar dhe me kerkesat nga Federata Shqiptare e Futbollit dhe te KLSH.Me ane te ketij projekt-vendimi kerkojme miratimin për fillimin e procedurave ligjore për shitjen me Ankand në masen 100% të aksioneve që Bashkia Pukë zotëron si aksionere e vetme në Shoqërine Klub Futboll "Terbuni"sh.a

Po ashtu theksojme se para hartimit të këtij projekt-vendimi është realizuar dhe konstultimi publik me date 25.02.2025 me përfaqësues të grupeve të ndryshme ku është marrë aprovimi për vazhdimin e procedurave. Procedura përkatëse e konsultimit bashkangjitur.

Situata financiare : Vlera e shitjes 5,200,000 (pesemilion e dyqindemije është përcaktuar në përputhje me procedurat lidhire nga nje ekspert auditues dhe vlersues i jashtem i cili ka pergatitur dhe nje raport te hollsishem per perllogaritjen e vleres se aksioneve i cili i bashkangjitet ketij relacioni. Kjo vlere do sherbeje si vlere minimale e nisjes se ankandit te hapur qe do te zhvillohet. Procedurat ligjore në vijim pas miratimit te ketij projet-vendimi dhe marrjes se shprehjes ligjore nga Prefekti do jenë sipas përcaktimeve ligjore me anë të Ankandit Publik te Hapur ku Bashkia

Puke do të zhvillohet në bashkëpunim dhe me Federatën Shqiptare të Futbollit dhe duke marrë eksperiencën nga procedurat e ngjashme.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Juridike ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni për Sherbime publike dhe prona dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Juridike.

Impakti social / grupet që preken: Projekti impakton Buxhetin e viteve të ardhshme dhe rrjedhimisht jetën e të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: Eshtë mbajtur dëgjesa publike me banorët dhe përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesit. Dëgjesa janë mbajtur sipas kalendarit të dëgjesave të publikuar në rregjistrin e konsultimeve me publikun.

Komisioni për Sherbime Publike dhe Pronave , i mbledhur me datën 17.04. 2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.1 datë 11/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për Për Miratimin për Shitjen me Ankand të Aksioneve të Klubit të Futbollit "Fk Tërbuni" SHA me Nipt L19704301f në masën 100%" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

GEJON GJOKA Kryetar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Besa Kançi Sekretar i Komisionit
(emri, mbiemri, firma)

Datë 17.04. 2025